

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Gjyqtari Skender Shala, ne çeshtjen juridike te paditesit i nga , te cilin e perfaqeson Avokati nga , sipas autorizimit me shkrim kunder te paditurit nga , per vertetim pronesie, vlera e kontestit 3.002 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe publik, te dt.12.10.2017, bie kete:

AKT GJYKIM

NE BAZE TE POHIMIT

I – APROVOHET, Kerkespacia e paditesit dhe **VERTETOHET** se paditesi nga , eshte pronar i pjeses se paluajtshmerise, ngastres katastrale nr. me kulture shtepi dhe oborr, are e klases se IV, ne vendin e quajtur “ ”, e cila me siperfaqe prej **S=574 m2**, me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes , e cila evidentohet ne baze te çertifikates se pronesise nr. , qe evidentohet ne emer te babait te te paditurit) 1/1 ZK

II – OBLIGOHET i padituri qe t'ia njohe kete te drejte paditesit dhe t'i lejoje qe paditesi kete paluajtshmeri ta regjistroj ne emer te tij, ne librat e tokes te Zyra Kadastrale Komonale ne , ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi, nen kercnim te permbarimit te dhunshem.


Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

A r s y e t i m

Paditesi ne padin e tij te parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tij ne seancat e mbajtura ka theksuar se ai ne vitin 1967, sipas kontrates gojore me shitesin – babain e tani i paditurit ; me çmim prej 90.000 DM, te cilin e ka paguar ne teresi ,ka blere paluajtshmerine e cila gjindet ne evidentohet pjese e ngastres kadastrale t. ,vendi I quajtur : me siperfaqe prej 600m2 ZK .Qe nga kjo kolle adietesi ka hy ne shfrytezim dhe posedim te kesaj paluajtshmerie,duke mos qene I pengur ga askush dhe edhe sot e shfrytezon pa penges.

Paditesi ne baze te shiteblerjes dhe mbajtjes me mirebesim e ka fituar te drejten e rones per kete paluajtshmeri, andaj ka interes juridik qe te vertetohet se ai eshte pronar i leses te kesaj ngastre .

I autorizuari i paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesor dhe ne fjalen perfundimtare propozoi gjykatës qe padine dhe precizimin e kerkespacia se paditesit ta aprovoi si te azuar, perkatesishet te bie aktgjykim ne baze te pohimit, pas qe i padituri ne tersi e pranoj eskesepadine .



Ne rast te aprovimit te kerkespadise dhe pruarjes se aktgjykimit ne baze te pohimit , heq dore nga e drejta ne anekese .

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi .

I padituri ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise te paditesit deklaroi : se eshte e vertete se babai im paditeses i ka shitur patundeshmerine e cila eshte objekt i ketij shqyrtimi gjyqesor dhe se i njejti qe nga momenti i shiteblerjes ka hyre ne posedim dhe shfrytezim te pa penguar nga askush te kesaj patundeshmerije, e qe me pare babait tim i ka qishte paguar ne tersi qmimin e shiteblerjes. Nuk e kundershtoj propozimin e paditesit qe gjykata te bie aktgjykim ne baze te pohimit.

Heqe dore nga e drejta ne ankese ne rast te aprovimit te kerkesepadise.

Shpenzimet e procedures kontestimores nuk i kerkoi .

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor, zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 dhe nenit 148.1 te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: procesverbalin mbi vendeshiqimin C.nr. te dt.04.02.2015, ekspertizen gjeodete ne emer te ekspertit gjeodet te dt.10.02.2015, certifikaten e pronsise me nr te lendes te dt.10.02.2015 ZK , beri veshtrim ne skicen e terenit dhe ne kopjen e planit nga I njejti ekspert dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me lart, konstatohet se pas matjeve te kryera ne pjesen e parceles lendore nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit, me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne ka vertetuar se pjesea e paluajtshmerise lendore bien – gjegjesisht i perbejne pjesen e parceles te cekur me larte me masat dhe kufijt te shenuara si ne ekspertizen e dhene me shkrim dhe skicen e terenit, e cila eshte pjese perberse e kesaj ekspertize dhe te aprovuar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga procesverbali mbi vendeshiqimin e kesaj gjykate te cekur me larte konstatohet se gjyqtari me vrojtim te drejtperdrejte ne vend konstaton se paluajtshmerija lendore kufizohet ne anen lendore me rruge te karakterit dytesor, ne nanen jugore dhe veriore me prone private, ndersa ne anen perendimore po ashtu me rruge te karakterit dytesor. E njejta eshte e rrethuar me rrethoje prej bllokave te betonit. Ne kete paluajtshmeri eshte e ndertuar nje shtepi (P+1) ne vitin 1970 . Ne hyrje te oborrit jane te vendosura dyert e metalit qe sherbjene paditesit dhe familjes se tij per hyrjen ne oborrin e shtepise se tij. (sipas ekspertit gjeodet ne vendshiqim).

Nga Certifikata mbi te drejtat e prones se paluajtshme te cekur me lart, konstatohet se pjesa e parceles katastrale evidentohen ne emer te babait te te paditurit) 1/1 ZK

Nga skica e terenit te dt. 14.04.2016, shihet shtrirja e vendit per kufizimi dhe siperfaqja e paluajtshmerise tani lendore.



Nga kopia e planit e lëshuar nga Drejtoria Gjeodete Komunale ne perkufizimi i paluajtshmerise tani lendore.

shifet shtrirja si

Ne baze te nenit 28 p.4 te LMTHJP, eshte percaktuar se: Mbajtësi me mirebesim- J sendit te paluejtshem, mbi te cilin tjetri ka te drejten e pronsise, fiton te drejten e pronsise mbi kete send me parashkrimin. fitues me kalimin e kohes prej 20 (njetzet) vjetesh.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes, paditesi e ka pasur ne shfrytezim dhe disponim te lire kete paluajtshmeri dhe ate: me mirebesim dhe pa pengesa nga askush, andaj ne anen e paditesit ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronesise ne baze te mbajtjes e keto jane: mbajtja me mirebesim, koha e nevojshme si dhe shfrytezimi i papengueshem i ketyre paluajtshmerive.

Mbajtja me mirebesim ekziston nga se babai i paditesit kete paluajtshmeri e ka blere nga paraardhesi (babai) i te paditurit.

Koha e nevojshme mbi 20 (njetzet) vite, ekziston sepse paditesja e ka blere kete paluajtshmeri nga paraardhesi I te paditurit qysh nga viti 1967.

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes, paditesi ka hyre ne posedim dhe shfrytezim te lire dhe te papengueshem te kesaj paluajtshmerive te tij, gjere me tani.

Andaj, gjykata konkludon, se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesit me mbajtje, konform nenit 28 p 4 te LMTHJP.

Nga permbledhja e fakteve dhe arsytet ligjore te cekura me larte, mbi bazen e nenit 148.1 te LPK-es ; gjykata vendosi si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore, bazohet ne baze te nenit 459.1 te LPK-es.

Nga arsytet e cekura me lart u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.nr.856/2014 dt.12.10.2017.



KËSHILLE JURIDIKE: Ky aktgjykim eshte i plotefuqishem diten e shpalljes perkatesishte me dt.12.10.2017, pasi qe palet ndergjygjese heqen dore nga e drejta ne ankese.